

**MARENGLLEN VERLI****INFORMACIONE DHE OPINIONE TË DIPLOMATËVE  
AUSTRO-HUNGAREZË PËR KONGRESIN E DIBRËS\***

Nga Revolucioni Xhonturk i 3 korrikut 1908, i finalizuar me shpalljen e Kushtetutës të Perandorisë Osmane në Stamboll më 23-24 korrik dhe deri në çeljen e punimeve të Kongresit të Dibrës, të 23-29 korrikut 1909, kishte kaluar plot një vit. Gjatë kësaj kohe situata politike në trevat shqiptare, brenda kufijve të Perandorisë dhe më gjerë, kishte pësuar zhvillime e kthesa mjaft të rëndësishme. Zgjedhjet parlamentare të shpallura me ligjin elektorale, të 15 shtatorit 1908, të zhvilluara në nëntor dhe të finalizuara më 17 dhjetor me hapjen e punimeve të parlamentit, ndonëse shënuan një hap përpara krahasuar me periudhën e absolutizmit hamidian, përsëri ishin të disfavorshme për kombësitë që popullonin Perandorinë dhe për shtresa të ndryshme të popullsisë së saj, si p.sh. për çifçinjët etj. Dhuna shtetërore për të imponuar kandidatët e Komitetit xhonturk "Bashkim e Përparim", që kushtëzoi orientimin politik të shumicës së 26 deputetëve të dalë nga viset shqiptare, si edhe politika zyrtare e mohimit të çdo kombësie jo turke për hir të "osmanizmit", shkaktuan kudo pakënaqësi<sup>1</sup>.

Opozita e grupuar në Parlamentin Osman në partinë "Ahrar" ("Liberalët"), edhe pse përfaqësonte një konglomerat interesash, ndër to edhe interesat e qarqeve konservatore të Turqisë, duke parashikuar në program decentralizimin e administrimit të Perandorisë dhe vetëqeverisjen e provincave kombëtare, përkatësisht një autonomi të gjerë të tyre, bëri shumë pasues, duke dëshmuar njëherazi tendencën e kundërt të kombësive që përbënin shtetin shumëkombësh, me politikën nonsens, nacionaliste e asimiluese, të xhonturqve<sup>2</sup>.

---

\* Kumtesë e mbajtur në Dibër (Maqedoni), më 24 korrik 2009, në Konferencën Shkencore "100-vjetori i Kongresit të Dibrës (1909-2009)", organizuar nga Komuna e Dibrës në bashkëpunim me Shoqatën e Historianëve Shqiptarë në Maqedoni.

<sup>1</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll.II, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: "Toena", 2002, f. 397. (Ndër 26 deputetë vetëm një numër i vogël, ku bënin pjesë Ismail Qemali, Nexhip Draga, Hasan Prishtina, Shahin Kolonja, Bedri Pejani e ndonjë tjetër konsideroheshin përfaqësues të forcave atdhetare shqiptare, që kundërshtonin politikën xhonturke).

<sup>2</sup> *Po aty*.

Konsujt austro-hungarezë të kohës të akredituar në qendra të ndryshme të vilajeteve të Perandorisë Osmane në Ballkan, njoftonin në raportet e tyre për refleksionin në terrenin shqiptar, të përplasjeve në parlament, ndër të tjera, edhe për çështjen e hapjes së shkollave kombëtare në gjuhën shqipe, mandej për konfrontimet në viset shqiptare midis nëpunësve osmanë dhe përkrahësve të tyre me atdhetarët shqiptarë, ndaj të cilëve organizoheshin reprezalje etj.<sup>3</sup> Në këtë kuadër pati pushime të funksionarëve shqiptarë nga detyrat shtetërore, ndjekje e arrestime të anëtarëve të klubeve etj., dhe një varg formash të tjera presioni, që çuan në likuidimin e klubeve, dhunimin dhe fyerjen publike nga turma të nxitura fanatikësh të arsimtarëve e atdhetarëve të njohur dhe në krijimin e një situatë konfrontuese<sup>4</sup>. Xhonturqit kryen deri edhe atentate, kundër personaliteteve si Dervish Hima, Ismail Qemali etj.<sup>5</sup> Madje, qeveria xhonturke, me pretekstin e stabilizimit të rendit, nuk nguroi të përdorte për goditje masive edhe forcat e armatosura, si në rastin e Gjilanit në sanxhakun e Prishtinës, duke mbajtur kështu të tensionuar në kulm situatën në viset shqiptare<sup>6</sup>.

Shqiptarët natyrisht protestuan kundër trajtimit që iu bëhej. Në një telegram drejtuar Portës së Lartë nga fundi i majit ose fillimi i qershorit 1909, klubet atdhetare të Shqipërisë së Jugut, apo Toskërisë, njoftonte konsulli Bilinski nga Janina, ankoheshin: "Ne nuk mund ta kuptojmë arsyen e këtyre veprimeve .... të cilat sipas kushtetutës janë të palejueshme ... Ne e numërojmë veten ndër njerëzit ... që kanë punuar për shembjen e absolutizmit dhe rritimin e lirisë. Në qoftë se është faj të jesh shqiptar, atëherë sigurisht ne s'mund të themi asgjë, por në qoftë se nuk është kështu, ne shpresojmë se vullneti perandorak i Madhërisë Suaj nuk do të lejojë që nderi ynë të njolloset pa arsye..."<sup>7</sup>.

Ngjarjet e sipërpërmendura i nxitën konsujt austro-hungarezë në viset shqiptare të relatonin se xhonturqit "po mbanin qëndrim armiqësor ndaj nacionalizmit shqiptar" dhe se "duke zbatuar traditat hamidiane dhe në

<sup>3</sup> *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), Vj. 19.6.648. Raport sekret nr. 37 i konsullit Bilinski dërguar më 5 korrik 1909, nga Janina MPJ në Vjenë dhe Ambasadës së A-H në Stamboll; *po aty*, Raport i konsullit austro-hungarez të Manastirit, Posfai, nr. 9, 07.03.1909 për MPJ në Vjenë.

<sup>4</sup> *Po aty*. Dokumentohen 15 të pushuar nga detyrat shtetërore në Delvinë dhe ndjekje e arrestime të anëtarëve të klubit "Labëria" të Vlorës, të anëtarëve të kryesisë së klubit të Ohrit, ndër të cilët Hamdi Ohrit, etj. Më 24 korrik 1909 në Tiranë u sulmua dhe u fye publikisht nga elementë fanatikë Refik Toptani, kurse më 27 korrik klerikët atdhetarë Hafiz Ibrahim Dalliu, Beqir Luga etj.

<sup>5</sup> Teuta Hoxha, *Ismail Qemali* (Përmbledhje dokumentesh), Tiranë: 1982, f. 126.

<sup>6</sup> *AIH*, Vj. 19.6.648. Raporte të përmendura të 5 dhe 9 korrikut 1909.

<sup>7</sup> *Po aty*, Vj. 19.6.648, raport sekret i Bilinskit nga Janina i 5 korrikut 1909.

kundërshtim me premtimet e tyre solemne, po persekutonin çdo çfaqje të ndjenjave kombëtare shqiptare"<sup>8</sup>.

Atdhetarët shqiptarë, gjithsesi e shfrytëzuan shpalljen e "Hyrietit" në korrik 1908 për të themeluar klube shqiptare në shumë vise, në qytete e fshatra<sup>9</sup>, madje ngritën pranë tyre edhe komitete të fshehta që zhvillonin veprimtari politike për autonominë e Shqipërisë<sup>10</sup>, gjithashtu hapën gazeta në vend dhe në diasporë, si edhe shumë shkolla shqipe, duke arritur që 14-22 nëntor 1908 deri në organizimin në Manastir të një Kongresi për njësimin e alfabetit të gjuhës shqipe. Pasant botime të librave të ndryshëm, veçanërisht të atyre shkollorë, të kanonizmave të shoqërive etj.<sup>11</sup>

Reagimi i xhonturqve në rastin e fushatës elektorale dhe të zgjedhjeve parlamentare në tetor-nëntor 1908, nxitja në fillim të shkurtit 1909 e mitingjeve turkomane kundër klubeve atdhetare, kundër përdorimit të alfabetit me shkronjat latine, urdhërat e Ministrisë së Arsimit që shqipja të mësohej të shkruhej me shkronjat arabe dhe, madje, formimi në Stamboll, me nxitjen e qeverisë, në janar të 1909-ës, i "Shoqërisë për mësimin dhe për shkrimin e gjuhës shqipe me shkronja turqishte", të gjitha këto, në vend që të çonin në shuarjen e zërave kundër qeverisë, acaruan më tej situatën<sup>12</sup>.

Është për të shënuar se në shkurt dhe mars të vitit 1909, ndër zonat ku regjistroheshin veprime kryengritëse ishte edhe rajoni i Dibrës. Sipas shtypit të

<sup>8</sup> *Historia e Popullit ...*, vëll. II, f. 404.

<sup>9</sup> Qysh më 31 korrik 1908 u themelua klubi shqiptar "Bashkimi" në Manastir me kryetar Fehim Zavalanin. Pasant rreth 40 klube të tjerë në Korçë, Vlorë, Elbasan, Shkodër, Shkup, Kumanovë, Tetovë, Berat, Selanik, Stamboll, Durrës, Tiranë, Pogradec, Janinë, Filat, Gramsh, Gjirokastër, Ohër, Strugë, Gjilan, Dibër, Vuçiternë, Tepelenë, Delvinë, Follorinë, Kurvelesh, Përmet, Pogon, Konicë, Negovan, Bellkamen etj. (Shih: *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, vëll. II, Tiranë: 2008, artikulli "Klubet Shqiptare", f. 1190; Shih edhe *Historia e Popullit ...*, vëll. II, f.381).

<sup>10</sup> *Historia e Popullit ...*, vëll. II, f. 384; Muzafer Bislimi, *Shqiptarët dhe revolucioni xhonturk*, Shkup: 2008, f. 131. Komitete u ngritën në Vlorë në gusht 1908, pranë klubit "Bashkimi" në Manastir, në Shkup, Ohër, Dibër, Prizren, Gjakovë, Pejë, Prishtinë etj.).

<sup>11</sup> *Historia e Popullit ...*, vëll.II, f. 384, 387, 389, 391. Në këtë kohë në Korçë filluan të botohen gazeta "Korça", që vijoi deri më 1910, "Lidhja Ortodokse" etj., në Boston "Dielli", "Shqypja e Shqipnisë" në Sofje, "Liria" në Selanik etj. Shkolla u hapën në Elbasan, Tiranë, Berat, Vlorë, Kaninë, Gjirokastër, rifilloi shkolla e vashave në Korçë, u hapën shkolla në Filat, Luros-Çamëri, në Manastir, në Nistrovë të Dibrës, në disa fshatra të Myzeqesë etj.

<sup>12</sup> *Po aty*, f. 402-404.

kohës shqiptarët e këtij rajoni kishin lidhur besën dhe i kishin kërkuar autoriteteve ndër të tjera hapjen e shkollave në gjuhën shqipe<sup>13</sup>.

Sikur të mos mjaftonte kjo situatë konfliktuale e brendshme, u përkeqësua edhe situata ndërkombëtare. Qarqet drejtuese të shumë shteteve evropiane e ballkanase nuk ishin më për frenimin e tatëpjetës së Perandorisë. Nga ana tjetër xhonturqit promovuan një politikë mjaft agresive. Me rastin e përgatitjeve për zgjedhjet parlamentare, pa menduar pasojat, ata parashtruan çështjen e pjesëmarrjes në këto zgjedhje të banorëve të Bosnjës, madje Egjyptit, Algjerisë, Tunizisë. Për pasojë ndodhi aneksimi i Bosnjës nga Austro-Hungaria në tetor 1908 (ishte pushtuar qysh më 1878 me vendimet e Kongresit të Berlinit), shpallja e pavarësisë së Bullgarisë, invadimi i Kretës nga Greqia etj.

Goditjet e sipërpërmendura dhe propaganda e përgatitjet që filluan shtetet e Ballkanit, për ballafaqim me Perandorinë, sollën shqetësime jo vetëm në Stamboll por edhe në trevat shqiptare, megjithatë xhonturqit nuk arritën të formonin në viset shqiptare një front unik pro tyre, me prirje veçanërisht antiaustriake, sikurse patën synuar. Madje ata vijuan me politikë agresive në planin e brendshëm, duke atakuar shqiptarët dhe përpjekjet e tyre për të drejta kombëtare dhe autonomi administrative. Koncepti i tyre pasqyrohet në prononcimin e kryetarit të atëhershëm të qeverisë, Haki Pashës, para kabinetit: "Rreziku më i madh për Perandorinë janë shqiptarët, deklaroi ai. Shqiptarët, që tani kanë filluar krijimin e themeleve të gjuhës dhe alfabetit të tyre, një ditë do të mund të sundonin tërë Turqinë. Kjo duhet të ndalet. Duhet t'i ndajmë dhe të krijojmë përçarje ndërmjet tyre"<sup>14</sup>.

Në këto rrethana kundërrevolucionari hamidian në Stamboll i 13 prillit, i cili në Dibër e Kosovë kishte një farë përkrahje te paria, te klerikët fanatikë dhe te disa oficerë të ushtrisë, por jo në popullin dhe në kryengritësit e Dibrës e të Kosovës dhe as te grupi i deputetëve shqiptarë, u likuidua relativisht shpejt (29 prill)<sup>15</sup>. Megjithatë ky kundërrevolucion dhe veçanërisht kryengritjet në vise të ndryshme shqiptare, e shkërmoqën përfundimisht përpjekjen e xhonturqve për të stabilizuar pushtetin e tyre. Konfrontimet e armatosura të shqiptarëve në

<sup>13</sup> *Po aty*. Shih edhe *Veçerna Poshta*, god. 9, 2682, 22.02.1909, Sofija; M. Bislimi, *vep. e përm.*, f. 185. Mitingje turkomane kundër klubeve atdhetare dhe kundër përdorimit të alfabetit latin pati në Manastir, Dibër, Follorinë, Perlep etj. Urdhërsa që shqipja të mësohej me shkronja arabe pati në fund të vitit 1908 dhe në shkurt 1909 për shkollat e vilajetit të Kosovës, për prefekturën e Elbasanit, për Janinën, Filatin etj. Përsa i përket "Shoqërisë për mësimin dhe shkrimin e gjuhës shqipe me shkronja turqishte" ajo përbëhej kryesisht nga ulematë myslimanë dhe bënte thirrje e shpërndante abetare shqipe me alfabetin arab.

<sup>14</sup> Hysni Myzyri, *Arsimi kombëtar shqiptar (1908-1912)*, Prishtinë: 1996, f.29.

<sup>15</sup> Shih M. Bislimi, *vep. e përm.*, f. 195, 196, 200. Në Dibër Njazi bej Resnja për shtypjen e kundërrevolucionit rekrutoi rreth 3000 dibranë në përkrahje të xhonturqve.

Gjakovë me trupat e Xhavit Pashës në majin e 1909-ës, apo në Qafën e Morinës më 12 qershor me trupat e Dervish Pashës, si edhe aktivizimi maksimal i atdhetarëve për të siguruar njohjen e kombit dhe autonominë e Shqipërisë, d.m.th. të "Vilajetit shqiptar", që do të përfshinte të gjithë viset shqiptare<sup>16</sup>, ishin zhvillime që i nxitën xhonturqit, sikurse theksonin konsujt austro-hungarezë Bilinski (nga Janina) dhe Posfai (nga Manastiri), të llogarisnin raportin e forcave<sup>17</sup>. Pasi kishin ndërmarrë disa nisma të pjesshme politike për të përfituar përkrahjen e kombësive të ndryshme të Ballkanit Osman ata synuan organizimin e një manifestimi në përmasa mbarëshqiptare, madje mbarëballkanike, që do të duhej t'u përmirësonte imazhin e qeverisjes së pasuksesshme duke siguruar mbështetje, veçanërisht të shqiptarëve, për ideologjinë dhe politikën e tyre. Me sa duket ky manifestim duhej t'i dilte përpara edhe Kongresit të Elbasanit, të parashikuar nga atdhetarët shqiptarë për t'u mbledhur më 22 gusht (pas një shtyrje të parë), për problemet e arsimit shqip, i cili binte ndesh me ideologjinë dhe politikën e xhonturqve<sup>18</sup>.

Sipas njoftimit që merrte ambasadori i A-H, Pallaviçini në Stamboll më 21 korrik 1909, nga Mitrovica dhe Vlora, informohej se në ftesën telegrafike të klubit shqiptar të Dibrës për mbledhjen që do të bëhej në këtë qytet, program ishte "qëndrimi që duhet të merret kundër ndarjes së Maqedonisë, si edhe vënia

---

*AIH*, Vj. 19.14.1479, nr. 58 (foto 313). Përmendim thirrjen apo manifestin e Ismail Qemalit drejtuar "vëllezërve shqiptarë" në korrik 1909. Sipas I. Qemalit "Vilajeti shqiptar", do të kishte si kryeqytet Ohrin ose Elbasanin dhe do të përfshinte sanxhakun e Janinës, Prevezës, Gjirokastrës dhe Beratit në Vilajetin e Janinës, madje sanxhaqet e Durrësit dhe të Shkodrës me Malësinë në vilajetin e Shkodrës, më tej sanxhaqet e Manastirit, Dibrës, Korçës, Elbasanit, si edhe kazanë e Grebenesë të sanxhakut të Selfixhesë në vilajetin e Manastirit dhe së fundi, sanxhaqet e Shkupit, Prishtinës, Pejës dhe Prizrenit në vilajetin e Kosovës. Sipas atasheut konsullor fon Rudnaj, në raportin e tij të dt. 31 korrik 1909, dërguar nga Mitrovica, ambasadorit të A-H në Konstandinopol, kontit Johan von Palavicini, Proklamata në fjalë, dërguar nga Roma, u kishte shkuar 10-12 krerëve shqiptarë aty, si edhe famullitarit katolik Dom Tomë Berishës. Në shtojcën me dokumente në fund të artikullit po japim të plotë proklamaten, kopjen e së cilës zv.konsulli Kraus nga Vlora ia dërgonte ministrit Erental në Vjenë (*AIH*, Vj.19.50, Raport i zv.konsullit Kraus, Vlorë, 30 korrik 1909).

<sup>17</sup> *Po aty*, Vj. 19.13.1371. Raport sekret nr. 55, dërguar më 31 korrik 1909 nga konsulli i Manastirit, Posfai, për kontin Alois von Ehrenthal, ministër i Punëve të Jashtme në Vjenë.

<sup>18</sup> *Po aty*. Ndër nisimat e sipërpërmendura llogaritet tentativa në qershor 1909 në Shkup për formimin e një partie të quajtur "Partia Demokratike Otomane", në kuvendin themelues të së cilës morën pjesë 4 turq, 2 bullgarë, 1 serb, 3 çifutë, parti që synonte të paralizonte veprimtarinë e klubeve të ndryshme nacionale, apo "Kongresi i rumunëve otomanë" mbajtur në Manastir në 10 deri 11 korrik 1909. *Po aty*, Vj. 19.10.1080, nr. 39, fl. 17-23. Raporti i Bilinskit nga Janina dt. 8 korrik 1909, në MPJ në Vjenë, lidhur me Kongresin e Elbasanit. (Kongresi i Elbasanit në fakt u mbledh në shtator –M.V.).

në vijë e një afrimi të të gjithë kombësive atje”, por opinioni, i bëhej me dije ambasadorit, është “se, veç programit të shpallur, *do të bisedohen edhe çështje të tjera kombëtare shqiptare*”<sup>19</sup>. Ndërkohë konsulli nga Shkodra, më 20 korrik, siguronte ambasadorin Pallaviçini se xhonturqit e mohonin nga frika zgjimin kombëtar të popullit shqiptar, por “simptomat për këtë janë të pamohueshme”. Zgjimi kombëtar kishte ndodhur si një zhvillim pa kthim dhe, sikurse relatonte konsulli i Manastirit, “shqiptarët, që do të mblidhen [në Dibër], ... nuk do të mungojnë ..., siç po përgatiten tani në takime të fshehta, të diskutojnë thjesht për *interesat kombëtare shqiptare*. Për këtë, shton diplomati austro-hungarez, ata në Dibër kanë ndër mend të banojnë pranë njeri tjetrit dhe për këtë janë bërë gati shtëpitë që do t’i presin”. Ai përmend edhe idenë e atdhetarëve të klubit të Manastirit për të propozuar që, me të mbaruar “mitingu” në Dibër, “të shkojnë në Elbasan .... ku më 10 gusht (allaturka) do të caktohet të mblidhet kongresi kombëtar shqiptar...”<sup>20</sup>. Njëherësh ambasadori informohet se në Shkodër qarkullonin lajme se në mbledhjen e Dibrës nuk ishin ftuar delegatë nga

<sup>19</sup> *Po aty*, Vj. 19.11.1110, Nr. 55. Njoftim nga Mitrovica, i 21 korrikut 1909, për Johan von Pallaviçinin në Stamboll. Nga Vlora, zv.konsulli Kraus, më 21 korrik 1909, dërgonte, bashkangjitur me një raport konfidencial me nr. 61, edhe një kopje të ftesës që u shpërnda për thirrjen e Kongresit të Dibrës nga Komiteti i partisë konstitucionale otomano-arnaute në Dibër (*Po aty*, Vj. 19.1.191, Nr.63 konfidencial, Vlorë, 21 korrik 1909). Më poshtë riprodhohet përkthimi i shkurtuar i ftesës:

“Kartat, të cilat u hartuan deri para një viti për copëtimin e Maqedonisë dhe të Shqipërisë, u grisën dhe u bënë të pavlefshme. Providenca hyjnore nuk mund të duronte më gjatë turpin që pësoi nga qeveria e mëparshme dhe ai u zhduk nën dritën e bashkimit dhe të vëllazërimit. Në sajë të këtij ndriçimi hyjnor, u zhduk grindja e vjetër fetare dhe kombëtare, jo vetëm tek neve por edhe në të gjitha pjesët e Perandorisë.

Në qoftë se ndokush do të donte që të gllabëronte edhe vetëm një pëllëmbë të tokës otomane të shenjtë, atëherë do të ketë një gjakderdhje që historia deri sot se ka parë.

Ndërkaq neve nuk duam gjakderdhje, por një pranverë të re.

Fuqitë e Mëdha duhet t’i shikojnë shpresat tona me sy dashamirëse dhe të na ndihmojnë, ashtu siç i përshtatet civilizimit.

Për të treguar unanimitetin tonë, në emër të zotit ju dërgojmë ftesën që këtej nga Dibra, qendër e Shqipërisë, që populli të dërgojë këtu përfaqësonjës të denjë muhamedanë, që të marrin pjesë në bisedime në datën 10 korrik për qëllimet e përmendura më lart, si dhe në festimet e 9 korrikut.

Dashuria ndaj Atdheut të shenjtë do të lehtësojë edhe mundimet.

Patriotë! Ne u presim juve patjetër!

Komiteti i Partisë konstitucionale otomano-arnaute në Dibër”.

<sup>20</sup> *Po aty*. Vj. 19.11. 1109. Relacion i konsullit të Manastirit, Posfai, dt. 19 korrik 1909, për ambasadorin e A-H në Stamboll, Pallaviçinin.

Toskëria, që, për shkak të nacionalizmit të përparuar, xhonturqit i konsideronin të pasigurt politikisht<sup>21</sup>.

Vend pritës për organizimin e kongresit, projektuar në Komitetin Qendror të Partisë “Bashkim e Përparim” si një kongres i përgjithshëm osman, u zgjodh qyteti i Dibrës, kurse data e hapjes së tij u caktua 23 korriku (1909), pikërisht dita e përvjetorit (të parë) të shpalljes së Kushtetutës së Perandorisë.

Performanca dhe vendimet e këtij kongresi, përveç synimeve të përmendura më sipër, me sa duket, llogariteshin nga xhonturqit edhe si mbulesë për të fshehur ftohtësinë që pritej të vihej re në festimet e përvjetorit të Kushtetutës në viset shqiptare, çka edhe ndodhi, sikurse do të relatonin konsujt e akredituar në Vlorë, Mitrovicë e Prizren, në raportet e tyre të datave 27 dhe 31 korrik dhe 4 gusht 1909<sup>22</sup>. “Ndjenjat e disfavorshme të popullsisë kundrejt regjimit të ri janë si më parë, shkruante konsulli Prohaska nga Prizreni, ... mytesarifi e konsideron domosdoshmëri përforcimin e garnizonit”<sup>23</sup>.

Shqiptarët ndërkohë të rreshtuar në dy kampe (atdhetarët autonomistë – radikalë ose të moderuar dhe turkomanët- proxhonturq ose prohamidianë) kishin objeksionet e veta për të synuar në Kongresin e Dibrës, edhe pse këto ishin të panjësuar, ndonjëherë edhe të kundërta. Por, sipas zv.konsullit të A-H në Shkup, Adamkieviç, shqiptarët përgjithësisht vlerësonin se, “të paafte për të dalë nga prapambetja kulturore me forcat e veta, u duhej impulsi i jashtëm, që këtë herë u bë nga xhonturqit”. Kjo rrethanë, e lidhur me situatën ndërkombëtare, arsyetonte Adamkieviçi, mund të ketë kontribuar që [ata] iu bindën shpejt ftesave për një kongres”, ndërkohë që në raste të mëparshme kishin qëndruar ftohtë<sup>24</sup>. Me sa duket situatën e tillë xhonturqit e menduan të favorshme për ta shfrytëzuar në interes të politikës së tyre. Nëse do të arrinin ta kontrollonin Kongresin ata do të legjitiminonin në popullsinë e rajonit, veçanërisht te shqiptarët, politikën e tyre të “osmanizmit”.

Konsujt austro-hungarezë njoftonin se Kongresi u quajt “*Kongresi Kushtetues i përbashkët shqiptaro-osman*” dhe, sipas konsullit të Manastirit, Posfai, “qëllimi i mirëfilltë i kësaj Asambleje ka qenë t’u japë sigurinë

<sup>21</sup> *Po aty*, Vj. 19.11. 1116, Nr.65, Raport i Kralit nga Shkodra, dt. 20 korrik 1909, për Pallaviçinin.

<sup>22</sup> *Po aty*, Vj. 19.9.953. Nr.65, Vlorë 27 korrik 1909. “Përvjetori i parë ... i shpallun si festë kombëtare pati në Vlorë karakterin e festës zyrtare, raportonte zv.konsulli Kraus, ... muhamedanë dhe të krishterë treguan një indiferentizëm që binte në sy dhe që do të thoshte shumë...”.

<sup>23</sup> *Po aty*, Vj. 19.10.1059, nr. 69, Fk. 874-879, Prizren 4 gusht 1909, Relacion i Prohaskës.

<sup>24</sup> *Po aty*, Vj. 19.11.1117, nr. 58. Raport politik konfidencial i zv.konsullit Adamkieviç, nga Shkupi, dërguar ambasadorit të A-H në Stamboll, markezit Johan von Pallaviçinin.

xhonturqve se shqiptarët nuk ushqejnë kurrfarë synimesh për pavarësi dhe kurrfarë ndjenjash armiqësore ndaj regjimit...<sup>25</sup>.

Sipas von Poltanës, diplomatit të autorizuar, që relatonte nga Tirana, edhe pse për programin e mbledhjes së Dibrës nuk dihej gjë konkrete, shqiptarët shkonin në Dibër me mendimin se “qëllimi i Kongresit do të ishte që t’i demonstrojë botës së jashtme unitetin e gjithë shqiptarëve dhe të protestonte kundër aspiratave eventuale të fuqive të huaja mbi territorin shqiptar ... Por janë të shumta opinionet, vijonte diplomati austriak, se këtu nuk kemi të bëjmë me një manifestim spontan të shqiptarëve dhe se, për më tepër, mbledhja bëhet me influencën e Komitetit Qendror të xhonturqve<sup>26</sup>. Për paqartësinë e përmbajtjes së Kongresit të Dibrës informonte ministrin e Jashtëm Erental në Vjenë edhe një farë Adem Ninçiq nga Shkupi, më 22 korrik, i cili shkruante se, “me sa dukej, ishte fjala për një aksion bashkimi me karakter demonstrativ të kërkuar nga autoritetet për shkak të gjendjes politike dhe, sipas lajmeve konfidenciale, shqiptarët këtë kërkojnë ta përdorin për të shtruar për bisedim postulata nacionale dhe reklamacione<sup>27</sup>”.

Duke sintetizuar thelbin e angazhimit të çdo ane për mbledhjen e një Kongresi në Dibër, konsulli Kraus njoftonte nga Vlora, ministrin e Jashtëm në Vjenë se “... duhet të merret si e sigurt se mitingu i Dibrës bëhet nën impresionin e çështjes së Kretës, të marrëveshjes Anglo-Ruse mbi Revalin, që është akoma në fuqi, dhe të asaj të Austro-Hungarisë me Italinë mbi Shqipërinë. Popullsia e këtushme është e bindur, relatonte konsulli, se komplikacionet që mund të rezultojnë nga çështja e Kretës, do të shfrytëzohen nga të dy fuqitë e përmendura në fillim për të zgjidhur definitivisht problemet maqedonase, me ç’rast do të bëhet akute edhe çështja shqiptare dhe Austro-Hungaria e Italia do të jenë të shtrënguara të interesohen në kuptim të marrëveshjeve relative<sup>28</sup>”. Por konsulli Posfai, nga Manastiri, më 19 korrik informonte Vjenën edhe për disa detaje me interes, sikurse ishte, përveç çështjeve si ajo e Kretës, ajo e alfabetit për shqipen, çështja e detyrimit ushtarak etj. “Mitingu i Dibrës ... nuk është një manifestim kombëtar shqiptar, sikurse u shpall në fillim, relatonte konsulli ... Ftesat e para nga Dibra në Manastir iu shkuan vetëm shqiptarëve ... [por] pak

<sup>25</sup> *Po aty*, Vj.19.10.1073, Nr.52, Fk. 808-814. Raport i konsullit Posfai dërguar nga Manastiri, më 2 gusht 1909, ambasadorit Markgraf. Sipas një versioni tjetër të përkthimit të një raporti, që kryekonsulli Kral i dërgonte nga Shkodra, më 5 gusht 1909, ambasadorit Pallaviçini në Stamboll, Kongresi u quajt “*Kongresi Shqiptaro-osman për bashkimin e kushtetutës*” (AIH. Vj. 19.11.1118).

<sup>26</sup> *Po aty*, Vj. 19.1.193, Nr.54. Raport i dt. 22 korrik 1909, dërguar nga Tirana Baronit Erental në Vjenë nga i autorizuari von Poltana.

<sup>27</sup> *Po aty*, Vj. 19.1.192, Nr.118. Informacion i dt. 22 korrik 1909, nga Shkupi dërguar prej Adem Ninçiq, ministrit të A-H, Erental.

<sup>28</sup> *Po aty*, Vj. 19.1.190, Nr.63. Raport konfidencial nga Vlora i konsullit Kraus, dt. 21 korrik 1909, për ministrin Erental në Vjenë.

nga pak “Komisioni kushtetonyës” i formuar apostafat në Dibër për thirrjen e kësaj mbledhjeje ... iu drejtua të gjithë kombësive të tjera të vilajeteve maqedonase dhe shqiptare ... Karakteristike, thekson konsulli, është se askush nuk ka dijeni se cilat do të jenë çështjet që do të shqyrtohen atje”. Situata kur qeveria i ka të përqendruara trupat kundër Greqisë, shpreh opinionin e tij konsulli, i ka detyruar xhonturqit dhe konkretisht Guvernatorin e Përgjithshëm Fahri Pashën, të përpiqen “të fitojnë kohë” dhe nga ana tjetër të tentojnë “një nënshtrim paqësor të arnautëve të pabindur”<sup>29</sup>.

Në Kongres u ftuan me anën e autoriteteve lokale të Dibrës, përveç shqiptarëve edhe përfaqësues të kombësive të tjera të “5 vilajeteve shqiptare e maqedone”. Ndër 315 delegatë pjesëmarrës, sipas konsullit Posfai, 95 ishin të krishterë, kurse pjesa më e madhe e myslimanëve ishin të kombësisë shqiptare. Nga xhonturqit, vërente konsulli, ishin shumë oficerë, prej të cilëve një pjesë erdhën me rroba civile”<sup>30</sup>.

Gjithsesi, është e qartë, si nga zhvillimet e Kongresit edhe nga rezultatet, relatonin konsujt, se pjesëmarrja, apo përbërja e delegatëve brenda taborit shqiptar, nuk ishte si do të kishin dëshiruar xhonturqit. Sipas të dhënave të konsullit Posfai, “divergjenca midis ideve dhe synimeve të organizatorëve xhonturq, të cilët drejtonin nëpërmjet “osmanli arnaut meshrutiat komisioni” dhe pjesës së madhe të delegatëve, që përfaqësonin interesat kombëtare, doli në pah që në fillim”. “Në Kongres, vijon konsulli, doli në pah një rrymë kundër prestigjit xhonturk, veçanërisht prej delegatëve të Manastirit, Janinës, Lumës, Gjakovës dhe Prizrenit”, që kërkuan “të mos njihej asnjë pushtet tjetër veç atij legjislativ, ekzekutiv e administrativ”<sup>31</sup>. Këto qëndrime tregonin se me gjithë pengesat e krijuara nga autoritetet për seleksionimin e delegatëve, krahas atyre që konsideroheshin përkrahës të politikës xhonturke (të ardhur nga Selaniku, Shkodra, Durrësi e Vlora), në Kongres merrnin pjesë edhe atdhetarë laikë e klerikë të dërguar kryesisht nga klubet e shoqëritë atdhetare si *Vehbi efendi Dibra*, *Dervish Hima*\*, *Abdyl bej Ypi* (Starja), *Sotir Peci*, *Fehmi bej Zavalani*, *Hafiz Ali Korça*, *Loni Logori*, *Llambi Kota*, *Qazim beu i Dibrës*, *Aqif Pashë Elbasani*, *Beniamin Nosi*, *Jusuf Karahasani*, *Haxhi Hafëz Ibrahim efendiu*,

<sup>29</sup> *Po aty*, Vj. 19.1.181, Nr.53. Raport sekret i dt. 19 korrik i konsullit Posfai, nga Manastiri për Baronin Erental në Vjenë.

<sup>30</sup> *Po aty*, Vj. 10.10.1073, Nr. 52, Fk 808-814. Raport i konsullit në Manastir, Posfai, 2 gusht 1909. Sipas *FESH*, Tiranë, 2008, Vëll. II, f. 1254, në Kongresin e Dibrës morën pjesë 325 delegatë.

<sup>31</sup> *Po aty*.

\* *Dervish Hima* “thuhet se lojti një rol të rëndësishëm gjatë Kongresit, qëndrimi i patrembur e i bazuar mbi bindjen burrërore i tij meriton mirënjohje, relatonte kryekonsulli i Austro-Hungarisë në Shkodër, Kral, më 5 gusht 1909. (AIH, Vj. 19.11.1118, Shkodër, 5 gusht 1909).

Murat aga i Gjakovës etj.<sup>32</sup>, të cilët synonin autonominë e Shqipërisë. Këta atdhetarë ishin ndër aktivistët edhe për hapjen e shkollave shqipe, madje edhe të shkollave shqipe me fytyrë perëndimore, si ajo e Tiranës, e misionit amerikan protestant<sup>33</sup>. Në një raport të korrikut 1909, nënkonsulli Hala nga Durrësi, njoftonte ministrin Erental, se ndër ata që flisnin pareshtur kundër xhonturqve spikaste Dervish Hima, i cili “pothuajse hapur e paraqiste autonominë, si të vetmin shpëtim për Shqipërinë”. Për këtë arsye, shpjegonte Hala, u tentua arrestimi i tij në Durrës, ku e strehoi dhe e fshehu Dom Nikoll Kaçorri<sup>34</sup>.

Atdhetarët shqiptarë, në Kongresin e Dibrës, sikurse parashikohej, do t’u nxirrnin probleme xhonturqve dhe përkrahësve të tyre. Pas vdekjes së papritur të deputetit dibran Ismail Pashës, të caktuar për kryetar, ditën e dytë të “asamblesë” (24 korrik), shkruante konsulli Posfai, e mori kryesinë myftiu i Dibrës. Sipas një rendi dite të caktuar me sa duket më parë, Vehbi efendiu, “pa ndonjë formalitet, si p.sh. zgjedhja e një komisioni, paraqiti një projekt, katër pikat e të cilit, të përpunuara prej komitetit xhonturk, duhej të nënshkruheshin si rezolutë prej të gjithëve”<sup>35</sup>. Por punët nuk do të rridhnin si dëshironin xhonturqit. Qoftë problemet procedurale, qoftë problemet lidhur me çështjet e gjuhës shqipe, të detyrimit të përgjithshëm ushtarak, apo çështja e oportunitetit të mbledhjeve të rregullta si ajo e Dibrës, theksonte konsulli i përgjithshëm Kral i Shkodrës, u kthyen në arena të ballafaqimit të pikëpamjeve të xhonturqve, me pikëpamjet e shumicës nacionaliste, në Kongres<sup>36</sup>. Nga nacionalistët u kërkua arsimi i detyrueshëm në gjuhën shqipe dhe hapja e shkollave shqipe në gjithë Shqipërinë, theksonte Krali, edhe pse kjo kërkesë nga përkrahësit e xhonturqve u quajt e padrejtë”. Ndër këta përkrahës u shquan delegatët e Shkodrës, veçanërisht ata myslimanë, çka lidhej me sa duket me lëshimet e veçanta që u premtuan për popullsinë e këtij vilajeti<sup>37</sup>.

Ballafaqimi në Kongres, vijoi me veprimtari pas tij. Sipas konsullit Posfai, puna shkoi deri aty sa “pas përfundimit të Kongresit u mbajtën biseda

<sup>32</sup> *Historia e Popullit ...*, vëll. II, f. 412.

<sup>33</sup> *AIH*, Vj. 19.11.1196, Nr. 50. Relajon i 10 korrikut 1909 i nënkonsullit Hala nga Durrësi për ministrin në Vjenë, baron Alois fon Erental. Për shkollën në fjalë, sipas Halas, ishte nisur posaçërisht nga Bukureshti Kristo Dako.

<sup>34</sup> *Po aty*. Raport i 3 korrikut 1909 i Hala-s për ministrin Erental.

<sup>35</sup> *Po aty*, Vj. 19.10.1073 Nr.52, FK 808-814. Raport i 2 gusht 1909 i Posfai nga Manastiri për Markraf.

<sup>36</sup> *Po aty*, Vj. 19.11.1118. Raport i 5 gushtit 1909 i kryekonsullit Kral nga Shkodra për Palaviçinin në Stamboll; *Fjalori Enciklopedik ...*, vëll.II. Në artikullin “Kongresi i Dibrës” (autor K.Prifti) theksohet se “shumica e delegatëve ishin përkrahës të xhonturqve”.

<sup>37</sup> *AIH*, Vj. 19.11.1118. Raport i 5 gusht 1909 i Kral për ambasadorin Pallaviçini.

mbi kombin shqiptar (prej myftiut të Korçës dhe të Manastirit) dhe u telegrafua në Stamboll për faljen e shqiptarëve të arrestuar”<sup>38</sup>.

Për të bërë presion mbi grupimin e atdhetarëve shqiptarë pjesëmarrës në Kongresin e Dibrës, xhonturqit, qoftë para mbledhjes së tij, qoftë gjatë ditëve që ai zhvillonte punimet, vunë në lëvizje përkrahësit e tyre në vise të ndryshme. Spikatin në këtë kuadër manifestimet dhe sulmet në Tiranë më 24 korrik, pra një ditë pas çeljes së Kongresit të Dibrës, të elementeve fanatike kundër klubit atdhetar dhe shkollës shqipe. Sipas raportit të V.Polanzit nga Tirana dhe telegrameve të nënkonsullit Halla nga Durrësi, rreth 200 fshatarë fanatikë të periferive të Tiranës, nga rajoni Shijak – Tiranë, u dyndën të armatosur në Tiranë dhe bënë presion mbi bejlerët atdhetarë të qytetit. Ndër të tjera, ata kërkuan të mbyllej klubi i shqiptarëve këtu, të internoheshin 64 anëtarët e tij dhe të dëboheshin misionarët amerikanë<sup>39</sup>. Nën presion ishte edhe Klubi i Shkupit, ku, sipas diplomatit austro-hungarez Adamkieviç, “shumë nga arnautët ..., me përzjerjen e tyre me elementin turk, e kanë humbur karakterin e tyre kombëtar” dhe “ka një rrymë të fortë në favor të shkronjave arabe”<sup>40</sup>.

Por, pavarësisht nga presionet e sipërpërmendura, jashtë Kongresit dhe klimës së krijuar në Kongres, veçanërisht përmes tonit të diktatit të ushtarakëve pjesëmarrës, “katër pikat [e projektit xhonturk], sikurse relaton konsulli i Manastirit, u konsideruan të pamjaftueshme dhe delegati shqiptar, i Selanikut, Abdyl bej Ypi (Starja) ... protestoi me zjarr duke vënë në dukje të drejtat e njohura nga Kushtetuta, kundër ndalimit të diskutimit të lirë”<sup>41</sup>. Qëndrimi i tillë i fortë i shqiptarëve atdhetarë, të cilët “u tërhoqën për këshillim në teqenë e baba Shabanit”, i detyroi xhonturqit, që u mblodhën edhe ata për këshillim në “beledije”, të cedonin<sup>42</sup>. Madje zv.majori Ejub Sabri prej Ohri, shpirti i komisionit organizues, që përgatiti 4 pikat fillestare, fill pas përpjekjes së dështuar për të imponuar programin xhonturk braktisi Dibrën. Një delegacion prej 3 vetësh i xhonturqve ra përfundimisht dakort të pranonte që, një komision

<sup>38</sup> *Po aty*, Vj. 19.10.1073, Nr.52. FK 808-814; Relacion i 2 gushtit i konsullit Posfai nga Manastiri për Markrafin dhe Erentalin.

<sup>39</sup> *Po aty*, Vj. 19.92, nr.56. Raport i të autorizuarit V.Polanz nga Tirana, date 29 korrik 1909 për ambasadorin austro-hungarez në Stamboll. *Po aty*, Vj. 1990. Telegram i nënkonsullit Halla nga Durrësi, dt. 25 korrik 1909 për ambasadorin e Austro-Hungarisë në Stamboll.

<sup>40</sup> *Po aty*, Vj. 19.11.1200. Telegram nga Durrësi më 30 korrik 1909, për Halan. *Po aty*, Vj. 19.11.117. Raport i 6 gushtit 1909 i zv.konsullit në Shkup, Adamkieviç, për ambasadorin e Austro-Hungarisë në Stamboll, Pallaviçinin.

<sup>41</sup> *Po aty*, Vj. 19.10.1073. Raport i konsullit të Manastirit, Posfai, 2 gusht 1909 për Markrafin dhe Erentalin.

<sup>42</sup> *Po aty*.

prej 40 vetësh (8 vetë për secilin nga 5 vilajetet) “të përcaktonte një program më të hollësishëm”<sup>43</sup>.

Pikat e programit, që u hartuan si shtojcë, kaluan me shumë debat, sikurse rehatonte konsulli, posaçërisht për çështjen e shkollës shqipe (debati për alfabetin) për të cilin u vendos “të lihet i lirë të zgjidhet”<sup>44</sup>.

Pikat e tjera kishin të bënin me përmirësimin e kushteve të komunikacionit me çështjet kishtarë etj.<sup>45</sup>

Në këtë situatë qëndrimesh të ndryshme, Kongresi i Dibrës në fund të punimeve të tij, më 29 korrik, nuk mund të jepte më shumë se një produkt hibrid, që ishte rezultat i raportit të forcave për momentin. Rappaport, në 6 gusht 1909, njoftonte nga Selaniku MP Jashtme në Vjenë dhe Ambasadën austro-hungareze në Stamboll se, duke analizuar “rezolutat e Kongresit të Dibrës”, botuar në “Journal de Salonique”, “Kongresi paraqet një dështim (fiasko) nga pikëpamja e xhonturqve, si edhe e shqiptarëve ..., vendimet e tij vuajnë nga kontradikta të brendshme dhe duhen kundruar si produktet e pazbatueshme të një kompromisi artificial”<sup>46</sup>. “Vendimet u bënë në gjuhën turke,

<sup>43</sup> *Po aty*. Katër pikat ishin shtypur në gjuhën turke e shqipe nga shoqëria botuese shqiptare “e këtushme” relaton konsulli Posfai, çka le të kuptohet se ato u shtypën në Manastir. Sipas konsullit komisionit prej 40 vetësh iu bashkuan edhe 4 vetë “me vota konsultative” përkatësisht Sami bej Koka, që përfaqësonte valiun e Manastirit dhe inspektorin e përgjithshëm për Maqedoninë, dy dibranë dhe bullgari Shanof prej Kosturi (“meqë zgjedhjet u bënë sipas vilajetit dhe nuk u zgjodh asnjë bullgar”).

<sup>44</sup> *Po aty*. Për alfabetin arab këmbëngulën Riza Beu, drejtor i monopolit shtetëror nga Shkodra, Draga Beu, i biri i Mehmet Pashës prej Kallkandeleni, dhe plaku Haxhi Muhameti prej Vlorë; *po aty*, Vj. 19.10.1071, nr. 49, sekret, FK 820-821. Relacion i Posfai i datës 20.07.1909. Sipas konsullit Posfai, në relacionin e datës 20 korrik 1909, të dërguar pra tre ditë para fillimit të Kongresit, çështja e alfabetit dhe përgjithësisht problemit të arsimimit në vilajetet shqiptare sipas interesave të “osmanizmit” ishte një çështje e rëndësishme për xhonturqit. Guvernatori i përgjithshëm Fahri Pasha, sipas konsullit, kishte thirrur atë ditë Fehmi bej Zavalanin, që do të nisej për në Kongresin e Dibrës, dhe i kishte kërkuar të përkrahte planin e qeverisë për hapjen e afërt të dy shkollave turko-shqiptare me internat në Dibër dhe Elbasan, ku me shpenzimet e shtetit do të mësonin nga 700 konviktorë në secilën. “Feim Beu, shkruante Posfai, nuk e hëngri të japë ndonjë përgjigje...”.

<sup>45</sup> *Po aty*. Lidhur me përmirësimin e komunikacionit theksi u vu veçanërisht për vijën hekurudhore që do të lidhte zonën Selanik-Manastir. Përsa i përket çështjeve fetare konsulli evidentonte ndër të tjera, kërkesën e revizorit shkollor vllah nga Korça, Ballamaçit, që vllahët dhe shqiptarët të kishin “një kryetar shpirtëror të vetin, në se patriku mbetej grek dhe në kisha të përdroreshin gjuhët amtare”.

<sup>46</sup> *Po aty*, Vj. 19.10.1072, Nr.60, fk. 816-818. Raport plotësues i Rappaportit nga Selaniku, i dt. 6 gusht 1909, për Markgrafin në Stamboll dhe MP Jashtme në Vjenë.

raportonte konsulli Kral nga Shkodra, në këtë gjuhë u bë pjesa kryesore e fjalimeve dhe bisedimeve<sup>47</sup>.

Synimi osman për të miratuar 4 pika, që do të dëshmonin solidarizimin e shqiptarëve dhe përgjithësisht ballkanasve me politikën e qeverisë xhonturke, nuk pati sukses. Por, patriotët, sipas konsujve austro-hungarezë, nuk ia dolën të shmangin miratimin e 5 pikave që përmbanin frymë të ngjashme, veçse këmbëngulën dhe arritën të impononin paraqitjen e tyre bashkarisht me 12 pika të tjera<sup>48</sup>.

“Xhonturqit, shkruante konsulli Rappaport nga Selaniku, më 6 gusht 1909, kishin në mendje idenë për të demonstruar lidhur me çështjen e Kretës dhe çështjet e tjera të mbetura pezull, që të mashtronin opinionin publik evropian e otoman me pamjen e një Shqipërie, e cila duhej të paraqiste kuintesencën e xhonturqizmit në Turqinë Evropiane ... Këtë qëllim ndjek ... pjesa e parë e propozuar e vendimeve ...

Ndërsa dështimi i xhonturqve, theksonte konsulli, qëndron në faktin që ata u detyruan të miratojnë pranimin e artikujve shtesë, të cilët ... nxjerrin në pah pozitën e posaçme të Shqipërisë, nga ana tjetër kompromisi i arritur nuk mund të cilësohet sukses as sipas pikëpamjes shqiptare, sepse [këta] nga njëra anë s’ia dolën t’i eliminojnë ose t’i dobësojnë pesë artikujt xhonturq dhe, nga ana tjetër, artikujt shtesë ... janë krejt pa lidhje, pra, pjesërisht me prejardhje nacionaliste, pjesërisht konservative ... Prandaj, ... mund të pohohet se Kongresi i Dibrës nuk paraqet një përparim, as lidhur me marrëdhëniet e xhonturqve me shqiptarët, as lidhur me bashkimin e brendshëm të këtyre të fundit dhe as vlen për orientim në kaosin e rivaliteteve nacionale në Ballkan<sup>49</sup>.”

Vendimet e Kongresit që përfaqësonin raportin momental të forcave të testuara, me sa duket, nga xhonturqit, me këtë rast, dëshmuuan se ata ndër shqiptarët kishin shumë kundërshtarë, se Lëvizja Kombëtare Shqiptare kishte rrënjë të thella, se ajo nuk ishte mashtruar e fashitur pas shpalljes së “Hyrietit”, nga kishte pritur tjetër gjë dhe jo zbatimin e politikës “osmaniste”. Për këtë arsye viset shqiptare, në përgjithësi, përfshi trevën e Dibrës, mbetën edhe më tej vatër e ndezur, çka do të konstatohej me manifestimin e shqiptarëve në Ferizaj, me 20-22 gusht, me shtrirjen e kryengritjes në Lumë, Pordrimë dhe në gjithë sanxhakun e Prizrenit, në fund të gushtit dhe gjatë ditëve të para të shtatorit, me

<sup>47</sup> *Po aty*, Vj. 19.11.1118. Raport i kryekonsullit Kral nga Shkodra, i dt. 5 gusht 1909, për ambasadorin e A-H në Stamboll, Johan von Pallaviçinin.

<sup>48</sup> *Po aty*, Vj. 19.11.1118. Raport i kryekonsullit Kral, dërguar nga Shkodra, më 5 gusht 1909, ambasadorit të A-H në Stamboll, Pallaviçinit, *Vendimet e Kongresit të Dibrës*, sipas këtij raporti, si edhe në dy versione të tjera të botuara, jepen të plota në fund të artikullit.

<sup>49</sup> *Po aty*, Vj. 19.10.1072, Nr.60, fk. 816-818. Raport plotësues i Rappaportit nga Selaniku, i dt. 6 gusht 1909, për Markgrafin në Stamboll dhe MP Jashtë në Vjenë.

përfshirjen e Dibrës në kryengritje në shtator, mandej me organizimin, me sukses më 2-8 shtator të një Kongresi Kombëtar në Elbasan, me hapjen e shkollës së rëndësishme Normale Shqipe të Elbasanit më 1 dhjetor, si edhe me një varg hapash politike, në nivele vendore e deri nga deputetët shqiptare të parlamentit në Stamboll, që kishin të bënin me paraqitjen e kërkesave kombëtare, me protesta kundër reprezaljeve ushtarake të Xhavit Pashës në viset shqiptare etj. Gjithsesi, për xhonturqit, në Ballkan shqiptarët mbeteshin i vetmi komunitet ku ata mund të shpresonin të mbështeteshin. “Sipas shenjave, konkludon konsulli austro-hungarez i Manastirit, Posfai, xhonturqit duan ta zhvendosin qendrën e gravitetit politik në vilajetet evropiane në elementin shqiptar muhamedan, me kusht që të bindet mjaftueshëm për lojalitetin dhe besnikërinë ndaj shtetit”<sup>50</sup>.

Të futur në një rreth vicioz, xhonturqit përballë qëndrimit të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, reagan në mënyrë iracionale. Kundërpërgjigjja e tyre, përveçse me armë kundër kryengritësve, u orientua edhe në fushën e arsimit dhe kulturës, duke aktivizuar elementet turkomanë. Në shkurt 1910 ata organizuan mitingje kundër shkollave shqipe dhe në përkrahje të përdorimit të alfabetit arab, në Shkup (2 shkurt), në Manastir (6 shkurt) dhe pastaj në Elbasan, Korçë, Gjakovë, Gjilan, Vuçiternë, Mitrovicë etj., kurse në fillim të marsit (4 mars), formon në Stamboll shoqërinë turkomanë “Rrethi arsimor shqiptar” (Arnavud mahfel mearifi) të kryesuar nga deputeti Haxhi Ali Elbasani. Brenda muajit shkurt patriotët shqiptarë i sfiduan në të njëjtën mënyrë me mitingje të fuqishme në mbrojtje të shkollës shqipe dhe alfabetit latin, në Elbasan, Korçë, Berat, kurse më 2-3 prill 1910 mblodhën Kongresin e Dytë të Manastirit. Viti 1910 do të ishte viti i një kryengritjeje të madhe shqiptare, që i vuri vulën mospajtimit të shqiptarëve me politikën shoviniste të xhonturqve, që po e çonte Perandorinë drejt fundit të shpejtë. Shqiptarët kishin rol të madh në këtë zhvillim transformues për rajonin, dhe në këtë kuadër, Dibra do të evidentonte peshën e vet të veçantë.

\* \* \*

### Proklamata e Ismail Qemalit e korrikut 1909\*

*“Vëllezër shqiptarë*

---

<sup>50</sup> *Po aty*, Vj. 19.10.1073, Nr.52, FK 808-814. Raport i konsullit Posfai nga Manastiri më 2 gusht 1909 për MPJ në Vjenë, ambasadën në Stamboll dhe konsullatën në Selanik.

\* *Po aty*, Vj. 19.50. Raport i zv.konsullit Kraus, Vlorë, 30 korrik 1909.

Ju që trimërinë e keni tuajën, malet i keni atdhe dhe sheshet me repa shtëpi, ju nuk e keni kuptuar akoma, se njeriu që kërkon të jetojë në liri nuk duhet të presë ndihmë nga të huajt. Ai vetë duhet t'i thyej hekurat e tij dhe me duart e tij të fitojë lirinë!

*Vëllezër shqiptarë:* A e dini juve se cili është kombi, bijtë e të cilit jeni ju. Jo, ju nuk e dini dhe nuk mund ta dini, se përndryshe zemrat do të qanin dhe ju nuk do ta duronit sot Shqipërinë dhe Shqiptarët në zgjedhën e skllavërisë. Ta dini Vëllezër! Ne Shqiptarët, që sot për sot jemi të poshtëruar para të gjithë botës, ne jemi raca më e vjetër dhe më e nderuar e Evropës.

Para Grekëve, para Romakëve dhe Bizantinëve ishim ne! Të parët tanë themeluan imperatorira të mëdha dhe me trimërinë e tyre ata mundën cilindo. Ky komb, që sot është i vobektë dhe i mjeruar i u ka rezistuar me trimërinë e tij të gjithë të huajve, që kanë dashur të invadonin Gadishullin Ballkanik. Ky komb me flamurin e trimërisë në dorë ka luftuar me të gjithë botën. Prej Vjene deri në Jemen dhe prej Persisë deri në rërën e Afrikës, toka është e vaditur me gjakun tonë. Shqiptarët kanë çliruar Greqinë, kanë ndihmuar Italisë dhe Turqisë i kanë sjellë lirinë.

Ka njëqind vjet që ne po luftojmë për të drejtat e njeriut dhe gjithë jetën tonë për lirinë. Kudo që ne shtrimë dorën korren sukses me nder dhe cilindo që e ndihmuam, ai ka fituar.

Vëllezër, ky komb i Shqiptarëve është sot i dënuar që të zhduket. Ne, që botën e kemi shpëtuar gjithnjë nga rreziqet e mëdha, ne do të shkojmë në greminë prej vetë fajit tonë, pse vetë nuk jemi të zotë që të kujtohemi për Shqipërinë e mjerë.

Të përçarë, të shqyer në copa, ne shkojmë pas fitimeve që na tregojnë të huajt dhe armiqtë tanë të atdheut, pa e kuptuar se fitimet e atilla janë për Shqipërinë humbje, humbje të mëdha. Kudo që ne shkojmë bëhemi të huaj për atdheun tonë, përbuzim dhe poshtërojmë vëllezërit tanë, të cilët, në mes të atyre maleve të atdheut, që ne të gjithëve na lindi dhe na rriti, ne i shikojmë të paditur dhe të vobektë.

Ku janë të parët tanë. Le të shikonin stërnipat e tyre, Shqiptarët e sotshmë, që kanë harruar Shqipërinë! Shqipërinë, që ishte për t'u shpëtuar dhe jo për t'u copëtuar, që e vaditën me gjak dhe që e forcuan me eshtrat e tyre. Ata nuk do të gjejnë asnjë qetësi në varr po të shikojnë tani Shqipërinë në rrezik. Çfarë presin ne Vëllezër? Ndhimën e të vdekurve? A po nuk jemi ne bijtë e tyre, që ishin kuintesenca e çdo trimërie?

Shqiptarë. Kur u shpall liria në imperatorinë otomane, ne kishim shpresa më të mëdha se çdo komb tjetër. Se, edhe në qoftë se ne ishim më të prapambeturit ndërmjet fqinjëve tanë, ne, me gjithë atë, shpresonim se me ndihmën e qeverisë së re, do të punonim për zhvillimin e gjuhës sonë, por ne u gabuam!

Faji për këtë ishte dhe është i yni. Ata, prej të cilëve ne shpreson aq shumë të mira për popullin tonë, u bashkuan me Komitetin Xhonturk "Bashkim dhe Përparim", por jo për të mirën e Shqipërisë, por për arsye personale.

Ta dini vëllezër! Ne nuk do të arrijmë që ta fitojmë kurrë të mirën tonë, përderisa ne e varim shpresën te të huajt! Se kjo shpresë na ka shkatërruar ne përgjithnjë!

Vuajtjet e patriotëve në Shqipërinë e Jugut, krimet në Shqipërinë e Veriut, përçarja e juaj, të gjitha këto janë pasoja sepse ne Shqiptarët nuk kemi guximin që të çelim gojën për të mbrojtur të drejtat e Shqipërisë dhe me qëllim që të mos dëmtojmë veten.

Vëllezër – prej të huajve ne nuk duhet të presim asgjë të mirë për Shqipërinë.

Shpresa e jonë – jeta e jonë t’i kushtohet “Autonomisë së Shqipërisë nën hijen e imperatorisë osmane!”

Në këtë mënyrë ka për t’u zgjuar dashuria për Shqipërinë dhe ka për t’u zhdukur shpresa tek të huajt.

Shqiptarë! Vëllezër! Patriotë!

A e doni ju me të vërtetë të mirën e vendit tuaj, a doni që populli juaj të mos bjerrë nën propagandën e huaj? Atëherë keni mendjen dhe kërkoni kudo prej qeverisë plotësimin e programit që vijon:

I. Të gjitha pjesët e vendit, ku flitet shqipja të mblidhen së bashku në një vilajet, që të quhet Vilajeti Shqiptar (Arnautlik-vilajet) dhe të ketë si kryeqytet Ohrin ose Elbasanin.

II. Brenda kufijve të tij ky vilajet të përmbledhë:

1. Në vilajetin e Janinës, sanxhakun e Janinës me kryeqytetin, Prevezën, Gjirokastrën dhe Beratin.

2. Në Vilajetin e Shkodrës: Sanxhakun e Durrësit, kryeqytetin Shkodër me Malësinë.

3. Në Vilajetin e Manastirit: Sanxhakun e Manastirit me kryeqytetin, Serfixhenë, kazanë e Grebeneës, Dibrën, Elbasanin dhe Korçën.

4. Në vilajetin e Kosovës: Sanxhakun e Shkupit, të Prishtinës, Pejës dhe Prizrenit.

III. Valiu të dërgohet nga Stambolli dhe do të varet nga Ministria e Brendshme.

IV. Pranë valiut të ekzistojë një këshillë e pleqve (mexhlisi idare), që ka për t’u marrë me çështjet e brendshme, me çështje të komunikacionit (me ndërtimin e rrugëve dhe të urave).

V. Me të hollat që paguajmë ne për arsim, qeveria të mbajë të gjitha shkollat elementare dhe shkollat e larta në Shqipëri. Gjuha shqipe në shkollat duhet të jetë e detyrueshme dhe duhet të mësohet krahas me gjuhën turqishte.

VI. Tagrabledhësat, nëpunësit e të dhjetave, nënoficerat e ushtrisë permanente dhe e radifëve duhet të dijnë që të lexojnë dhe të shkruajnë shqip.

VII. Nëpunësat që do të dërgohen për në Shqipëri do të jetë me dobi që të zgjidhen nga Shqipëria.

VIII. Në kohë paqe ushtria nuk duhet të përdoret jashtë kufijve të Shqipërisë!

Këto duhet të jenë qëllimet tona. Këto duhet të jenë dëshirat e çdo patrioti shqiptar. Vetëm në këtë mënyrë mund të mbajmë ne kombin tonë, Shqipërinë tonë, me ndihmën e Imperatorisë Otomane të Gadishullit Ballkanik! Çrregullimi, copëtimi janë rrënimi i ynë. Në bashkim qëndron fuqia.

Vëllezër! Të jeni prandaj të bashkuar, të frymëzuar prej vëllazërimit në interes të fesë sonë, të zmadhimit të kombit tonë dhe të përparimit dhe madhësisë së Shqipërisë !!!

\* \* \*

### Vendimet e Kongresit të Dibrës\*

“Përgjithësime.

---

\* *Po aty*, Vj. 19.11.1118. Raport i kryekonsullit Kral, dërguar nga Shkodra më 5 gusht 1909, ambasadorit të A-H në Stamboll, Palaviçinini.

1) Është e pamundur të asgjësohen ndjenjat tona të rrënjësura thellë që të jetojmë e të vdesim si otomanë. Këto ndjenja tona do t'ja u provojmë me force e me ngulm gjithë atyre që dyshojnë.

2) Ne hedhim poshtë me gjith energjinë mendimin (konceptin) se kushtetuta te otomanët nuk do të ketë një jetë të gjatë. Ne jemi kundër atyre që me anën e trazimeve ose me pohime të rreme, se gjoja parimet konstitucionale nuk pajtohen me fenë muhamedane, përpiqen ta rrënojnë [kushtetutën]. Pa bërë dallim cilës përkatësi kombëtare i përkasim, ne do ta përkrahim dhe asnjëri prej nesh nuk do ta lerë veten të gënjëhet nga të tilla shprehje, se kushtetutë do të thotë drejtësi dhe drejtësia është baza e së drejtës islamike. Prandaj kush i quan shqiptarët se janë kundra kushtetutës bëhet qesharak.

3) Kur çështjet e tanishme e ato që do të lindin në të ardhmen të politikës së jashtme nuk do të gjejnë zgjidhje të meritushme për nderin e qeverisë otomane dhe kur për mbrojtjen e nderit të të drejtave të Perandorisë Otomane do të dilte e nevojshme një luftë, fuqitë e armatosura që gjenden tashti të ndara në batalione dhe që, në rast nevoje, do të formohen të reja, me urdhërin e parë menjëherë do të mblidhen. Milicia ndihmëse shqiptare në një rast të tillë do të vrapojë në vend duke përbuzur vdekjen.

4) (Ekstrakt). Ndaj lëvizjeve eventuale revolucionare, që drejtohen kundër qeverisë tone konstitucionale dhe çrregullojnë qetësinë e vendit, si dhe sigurinë e personit e të pasurisë, ose ndihmojnë synimet e jashtme, ato trupa të nizamëve, që gjenden në vendin përkatës, në zbatim të urdhërave nga lart, duhet të ndërhyjnë menjëherë, por me kujdes e me rregull të plotë. Në rast nevoje duhet të thirren dhe trupa të tjera nga vende të tjera dhe vetkuptohet, gjithmonë në kuadrin e ligjeve, të përdoret eventualisht edhe forca.

5) Po të dale nevoja për marrjen e rekrutave në vendet, ku deri tashti s'ka qenë zakon, kjo mund të bëhet në bazë të një ligji të posaçëm, që mund të aprovohet në rrugë konstitucionale. Ligji i tillë pa kundërshtim duhet të respektohet.

#### **Punët administrative speciale:**

1) Mbasi vetmbrojtja arbitrare nuk pajtohet me parimet e një shteti të rregullt në të cilin garantohej siguria e personit, e pronësisë, pasuria e tundshme dhe e patundshme mund të preket vetëm në bazë të një vendimi gjyqësor të marrë më pare. Kundër përvetësimit të padrejtë, kundër vjedhjeve, duhet të merren masat e nevojshme.

2) Si për arsye strategjike ushtarake, ashtu dhe për përparimin ekonomik të rajoneve përkatëse me anën e lehtësimit të transportit të mallrave, kërkohet ndërtimi i hekurudhave, i rrugëve e urave, kanaleve, rregullimi i liqeneve dhe lumenjve si dhe zhvillimi i lundrimit.

3) Programi i mësimdhënies i shkollave të larta fetare duhet të riformësohet në atë mënyrë që të futen në të e të trajtohen me zell disiplinat e ndryshme të shkencave të tjera. Programi duhet të caktohet me përpikmëri dhe duhet të bëhen provime të rregullta. Nxënësit duhet të kenë arsimin përgatitor të nevojshëm. Atje ku do ta lypë nevoja duhet të hapen shkolla normale (pedagogjike). Programi i tyre duhet të përmbajë filozofi fetare, veçoritë e islamizmit mbi interpretimin e kuranit dhe këto lëndë duhet të recitohen nga nxënës të përshtatshëm. Shkollat që ekzistojnë duhet... (Në dokumentin që kemi në dorë mungon vazhdimi i pikës 3, dhe pika 4, 5 e 6, që nuk janë as në film – Shënim i përkthyesit).

7) Në kuptim të dispozitave ligjore ekzistuese kërkohet të merren trupat, që kanë shkuar në Hixhas e vende të tjera të nxehta, nga të gjitha forcat e armatosura (dhe jo duke preferuar një pjesë të tyre).

8) Në ankandin e të dhjetave nuk duhet të veprohet në bazë të vlerësimeve të viteve të kaluara, ose sipas një vlerësimi më të lartë, për të siguruar kërkesat e prapambetura të financës, siç ndodh aty këtu, por në bazë të vlerësimit nga ana e një komisioni ekspertësh të vlerës efektive.

9) Me qenë se humbjet dhe dëmet materiale e morale, që i referohen privilegjeve të shoqërisë së monopolit të duhanit kanë arritur tashti në një shkallë të padurueshme dhe koha e konçesionit sidoqoftë po skadon, duhet të përpiqemi që tashti për zgjidhjen me anë të një zhdëmtimi respektiv. Po qe se kjo është e pamundur duhet të heqim dorë medoemos nga zgjatja e konçesionit.

10) Për të ruajtur qëndrimin e çiltër (besnik) ottoman të të krishterëve ortodoksë shqiptarë, ose të atyre të kombësisë rumune, shkollat e tyre duhet të ndahen nga kisha e të vihen nën vartësinë e Ministrisë së Arsimit. Me qëllim të përdorimit të gjuhës amtare të tyre në kultin hyjnor, në kuadrin e konçesioneve të veçanta të ligjit të kushtetutës mbi lirinë e ushtrimit të fesë, duhet të emërohen priftërinj që të dine gjuhën përkatëse.

Veç kësaj kërkohet të pranohen përfaqësuesit e peshkopëve bullgarë si anëtarë permanent të komitetit administrativ.

11) Është e dëshirueshme që, sipas shembullit të Selanikut, në vende të tjera të formohen të ashtuquajturat komisione të bashkimit për të arritur një afrim të ngushtë e lidhje ndër pjesëtarët e racave të ndryshme.

12) Duke marrë parasysh dobinë e madhe të këtyre mbledhjeve, si kjo e kësaj here, vendoset që në çdo vit, në tetor, të mbahet në një pike që do të caktohet në Turqinë Evropiane, një kongres, i cili do të mbledhet për gjatë 15 ditë rresht. Çdo njeri nga të 6 vilajetet duhet të dërgojë në të 20 delegatë. Ai do të ketë emërtimin “Kongresi Shqiptaro-Ottoman për bashkimin e Kushtetutës”. Programi i Kongresit do t’u njohet vilajeteve nga vendi përkatës i mbledhjes.

\* \* \*

### **Vendimet e Kongreses të Shqiptarëve Otoman me emnin bashkim Constitutional\***

#### **Nyjat fëllimtare bashkimëtare.**

Nyj’ e I. Na kurrë s’kemi për të sjellë ndërmënt ato sende që na prishin e çkatërojnë ndjenjat tona të vërteta për me jetuar Osmanlli edhe për me vdekur Osmanlli. Sido që të jetë, na, kur ta lypnjë nevoja, atyre që do ta vendosin se ndjenjat tona janë ftohur e janë, dobësuar, do t’iu rrëfejme fuqinë e dashurinë atdhetare.

Nyj’ e II. Vendimi i pandehur q’është dhënë se gjoja “konstitutioni në osmanllinjë s’jeton” e flakim poshtë me gjith mish e shpirt. Disa njerës pandehin me disa intrika qeveriës otomane t’i qisin ngatresa e turbullime dyk e thënë se, constitutioni nuk i përshtatet fesë së naltë myslimane. Por se na, këta që luajnë një rol politikë të këtillë dyk

\* Abdyl Ypi, *Kongresa e Dibrës dhe Hafiz Ali Korça*, 1918.

e bashkuar me gjith elementat otomanë i luftojmë. S'ka as njeri prej nesh që ta besojë këtë renë politike. Constitution d.m.th. drejtsi edhe kjo është vet rënja e ligjës muslimanizmës.

Shqipatarët tallen me ata që po i ftohjin prej constitutionit edhe pandehin se Turqija prej Evropës po shkulet! Sepse ndë Shqiptarët ndodhet një ligjë (besa) q'ë lidhën vjet 10 korik 1324 edhe e çpallën. Këtë ligjë (besa) se sa e shtrenjtë edhe e fortë është e kallëzgjë shëmbllat historike. Shqiptarët për të shenjtëruar titullin constitutionin otoman vdekjen e quajn nder.

Nyj' e III. Çështjet politike që po rrjedhin sot e të tjerat që kanë për t'u çpikur midis qeverisë tonë dhe të jashtme po nuk u zgjidhën si na i do interesa, atëherë për të mbrojtur nderin e të drejtat e mbëretisë constitutionale do të përgatiten për luftë edhe sa klase ushtri që të lypnjë nevoja pa ndalim, me një shpejtësi të fortë të gjithë do të mblidhemi dhe do ta ç'krijmë jetën t'onë.

Nyj' e IV. Kurdoherë të dalë donjë ngatërresë e turbullim që prishë qetësinë e brendshme, tremb sigurimin e gjesë e të shpirtit dyk e mos pranuar ligjit të Sheriatit e të constitutionit të cilat kryengritje i shërbejnë mentimeve e dëshirave të jashtme, atëherë për të shtypur këtë lëvizje edhe për të sjellë në vënt urdhërin e qeverisë, sa kaqë fuqia ushtërijake do të mblidhet edhe ku e do nevoja do të hidhet, në mos mjaftoftë fuqia ushtërijake n'u ndodhtë lark, me të dhënë urdhrin qeverija ç'klase ushtërijake që të duhen do të mblidhen edhe për të shkelur kryengritjet fuqija mbretërore do të çfaqet e ku duhet do të duket.

Nyj' e V. Ndër ato vise q'akoma rekrutimin nuk është zbatuar, po të jetë se del dekreta mbretërore dyk e përshtatur vendimit që të dalë prej parlamentit edhe senatos, me gëzim të madh do të fillohet mbledhja ushtërijake në ç'do vend.

### **Nyjet ndjekse të nevojshme**

Nyj' e I. Bukur jetesa edhe ngjallimi i një shteti është sigurimi edhe qetsija. Por kurse gjëja e shpirti është siguruar nuk ka të drejtë as kush të ngrihet e të prishjë qetësinë për të siguruar interesat e të vërtetat e veta. Për të fituar të drejtat janë gjyqet, si kush që do të zotëroj gjanë e vetë prej grabitje do të mos ketë edhe der-uhdëxhillëku do të zhduket.

Nyj' e II. Për të siguruar udhëtimin e ushtërisë me një shpejtim të mundur të përgatiten udhët e hekurta, të bëhen shosat, të pastrohen kënetat, të thahen moçalet e disa lumenj që të mundet me anën e tyre të transportohen sendet e tundshme.

Nyj' e III. Të mirësohen medreset me një sistem si e do koha dhe të shtohen dhe shkencat e diturit e nevojshme modernë, nxënësit të provohen për vit, medreset të jenë mburimi i universiteteve, të çilen normale si për të qitur mësonjës ashtu edhe për mjeshtër për ç'do lloj mjeshtri, nëpër shkollat t'i jepet rëndësi ma të tepër filozofisë të fesë dhe Hazreti Kur-anit në Rumejli të çilet një faqyltë diturish, të çilen gjimnase dhe shkolla fillore kudo dhe në Shqipëri me doemos të msohet gjuha shqip nga an'e mësonjsve të paguar prej qeverisë, sa për shkronjat le të jenë si të dojë populli (?)

Nyj' e IV. Për sigurimin e rregullimit, para se të mblidhen ushtarët, duhet të çpallet nga qeverija civile sasija edhe klasi i tyre.

Nyj' e V. Mirësimet themelore që do të bëhen në Kryqytet, të përgjithësohen e të zbatohen me një shpejtim të fortë edhe nëpunësit që do të emrohen prej qeverisë duhet të dinë vetijat, zakonet, sjelljet, natyrat edhe gjuhën<sup>1</sup> edhe t'i jepet kompetenca gjith

këshillave të vilajeteve q' u fal ligji themeltar që kësisoj të sigurohet lumtërija e vërtetë e atdheut.

Nyj' e VI. Për me i dhënë funt zihjeve që rjedhin në kufit të Malit të Zi. Çështja e kufive në një kohë të volitshme e me një mënyrë të pëlqyeshme (nga anë) e qeverisë të zgjidhet.

Nyj' e VII. Ushtarët që do të dërgohen në viset e nxehta si Jemen e Hixhaz edhe në viset e tjera të largëta, të meren si pas rregullores q' u përbë sivjet edhe sasia e marrjes të vazhdojë me një caktim drejtësisje.

Nyj' e VIII. Pesëtimi i të dhetave sado q' i varet atyre blerësve edhe iu lëshohet në dorë, porse në disa vilajete të dhjetat iu lëshohen disa dhjetarve me një çmim fort të tepër nga shkak i arkës i kan ngelur borxh dhe qeverija pandeh se me këtë rast mundet të mblethnjë borxhet e vjetra e kështu mundet të humbasë dhe të rejtat. Pra të mos lëshohen me çëmimet e motit të shkurorë, por të formohen komisione prej njerës të provushim, prej bujzësh e tjerë dhe me anën e këtyre me të shpejt të caktohet çmimi e vlefata.

Nyj' e IX. Dëmet materialisht e moralisht që ka shkaktuar rezhija ka arrirë në një shkallë që më s' i sillt fuqi e më s' durohet. Me qenë se edhe koha e caktueme po i soset, në qoftë e mundur kompanisë t' i pagohet një çpërblim dhe të shgulet, në mos qënt e mundur me të sosur koha të ngrihet krejt.

Nyj' e X. Të krishterët, vllah e shqiptarë ortodoks pa të përmbajtur ndjenjat e larta otomane dëshirohet që shkollat e tyre të ndahen prej kishave edhe drejt për së drejti t' i varen ministrisë s' arsimit. Me qenë se ligji themeltar veprimet e zakonçme të çdo feje i ka lanë të lirët, dëshirohet qi t' emnohen nëpunës që dinë gjuhën e vetë që veprojnë. Sa për kryetarët e fesë të bullgarve, po ata me që janë kërkuar që të përfaqësojnë elementin e vetë nëpër këshillat e qeverive, padyshim të drejtat e tyre me këtë mënyrë janë siguruar.

Nyj' e XI. Nëpër çdo vise të formohen komisione të përzime prej gjith elementeve të ndryshme edhe kështu të forcohet vëllazërija e bashkimi i përgjithçim.

Nyj' e XII. Kjo kongresë q' u përmbledh sivjet me një lutësi dhe dha mjaftë vendimet të mbrothshme për mirësinë t' atdheut, për mot në krye të vjeshtës së dytë me shorte do të mblidhet në një vënt nga gjashtë vilajetet e Rumelisë. Sasija e delegjeve të çdo vilajeti do të jetë 20 veta. Kongresa do të vazhdojë 15 dit. Shpenzimet do të mos i ngarkohen qendrës së Kongresës. Programi i Kongresës shqiptare bashkim e konstitucional, t' iu paraqitet para se të mblidhen delegjetë pesëmbëdhjetë ditë më parë të gjashtë vilajeteve...

---

1) Por kjo fjalë u ngrit nga Zhon-Turqit.